



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr....., datë 2024

**PËR RREGULLAT E ZBATIMIT MBI KONTRIBUTIN E SEKTORIT PRIVAT NË
KRIJIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, pika 3 e ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat për krijimin e fondit publik të banesave sociale, në përputhje me përcaktimet e nenit 19 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar.
2. Në çdo rast, në marrëveshjen paraprake mes njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe subjektit privat që paraqet kërkesën për leje zhvillimi dhe ndërtimi, përcaktohet mënyra e përfitimit të fondit publik të banesave sociale, referuar sipërfaqeve me metër katror apo e dhënë ajo në vlerë leku sipas cmimit të referencës në fuqi për njësitë e banimit në zonën ku po ndërtohet, bazuar në sipërfaqen e përgjithshme funksionale të objektit të banimit në ndërtim, e cila lidhet në momentin e dhënies së lejes së ndërtimit/zhvillimit.
3. Sipërfaqja takuese referuar nenit 19 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar, në përmbushje të qëllimit të strehimit, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, subjekti privat e jep atë menjëherë në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi, në përputhje me normat e projektimit të banesave, të perfunduar dhe të certifikuar me dokumentin e pronësisë, duke e ekuivalentuar në vlerë monetare me zonën ku po ndërtohet objekti për të cilin është dhënë leja ndërtimore.
4. Për të gjithë ato subjekte që janë pajisur me leje ndërtimi dhe nuk kanë nënshkruar ende kontratën përfundimtare të kalimit të pronësisë me njësinë e vetëqeverisjes vendore, subjekti mund të propozoj që sipërfaqen ndërtimore në funksion të fondit publik të banesave sociale mund ta ofroj që ta japi në një sipërfaqe të ndryshme nga ajo që po ndërtohet, por me kushtin që sipërfaqja të jetë e përfunduar dhe e certifikuar me dokumentet e pronësisë. E konvertuar kjo sipas zonave përkatëse të referencës në fuqi.
5. Kontrata përfundimtare që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në

favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Kjo kontratë përmban të dhënat e sakta në lidhje me sipërfaqen, zonën, numrin e njësive të banimit dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

6. Në rast se kalimi i sipërfaqes ndërtimore është e dhënë në vlerë leku, fondi kalon nga investitori në llogarinë e posacme të njësisë së vetëqeverisjes vendore në favor të fondit publik të banesave sociale.
7. Ngarkohen njësitet e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

Edi Rama